



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:008329

Datë: 04.02.2021

Numri i dokumentit: 01475835

PKR.nr.11/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, sipas kryetares së trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj, me bashkëpunëtoren profesionale Elzana Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit Xh. Q., për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së*, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda nën shenjën PP/I.nr.28/21 të dt.20.01.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar të dt.01.02.2021, në të njëjtën ditë bie dhe shpall, ndërsa me dt.02.03.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Xh. Q.**, nga i ati S. dhe e ëma N., e gjinisë G., i lindur me në, tani me vendbanim në fshatin K., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me dokument identifikues lëshuar nga MPB të R. Kosovës, shqiptar, shtetas i R. Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me parë e gjerë me dt.04.01.2021 në orën 12:00, në fshatin K., i pandehuri në kundërshtim me neni 5 par.1 dhe nenit 2 par.1.29.3 të Ligjit për Armë Nr.05/L-022, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe atë: një pushkë gjuetie një tytëshe modeli 710 me numër serik 5153360 si dhe 109 fishekë në atë mënyrë që i pandehuri pasi që fillimisht dhëndri i tij e denoncon në polici se i njëjti posedon armë, i pandehuri në mënyrë vullnetare shkon në Stacion Policor në Istog dhe e dorëzon armën e cekur si më lartë.

- Me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 17, 38, 39 par.1 nënpar.1.2, 46 par.1 nënpar.1.1, 69 par.1 pika 3.5, 3.6 dhe 3.7, 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-së, si dhe nenit 360, 365, 366, 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPRK-së, të njëjtit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ku më parë i përcakton dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, në të njëjtën kohë urdhërohet që dënimi me burgim të mos ekzekutohen në afat prej një (1) viti, nëse i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej njëzet (20) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që si taksë shtesë në emër të programit për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 366 par.3, të KPRK-së,

KONFISKOHET- pushka gjuetie një tytëshe modeli 710 me numër serik 5153360 si dhe 109 fishekë.

URDHËROHET- që pushka gjuetie një tytëshe modeli 710 me numër serik 5153360 si dhe 109 fishekë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

A r s y e t i m

Historiku i rastit.

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/I.nr.14/21 të dt.14.01.2021, kundër të pandehurit Xh. Q. , për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.*

Lënda në punë është pranuar me dt.21.01.2021.

Me dt.01.02.2021, është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë, bazuar në dispozitën e nenit 244 të KPPRK-së, është konstatuar se Prokurorja e Shtetit, i ka përmbushur detyrimet dhe mund të vazhdohet me mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës, Kryetarja e trupit gjykues, është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohej për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e udhëzuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konform dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së dhe atë me natyrën e veprës penale e cila ndëshkohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vite, se pranimi duhet të jetë i vullnetshëm, se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, por i mohohet e drejta e paraqitjes së ankesës, për shkaqe tjera pos shkakut për vendim të dënimit.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion nga askush.

Kryetarja e trupit gjykues, ka marr mendimin nga Prokurorja e Shtetit, e cila është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasur parasysh se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat të cilat i janë bashkangjitur aktit akuzues.

Kryetarja e trupit gjykues, ka aprovuar pranimin e fajësisë e bindur se pranimi i fajësisë është bërë në përmbushje të kushteve ligjore të nenit 248 par.1 pika 1.1 deri 1.4 të KPPRK-së, i cili pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës siç janë: vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshme të sendeve i dt.04.01.2021, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt.04.01.2021, lista e dëshmimeve e dt.04.01.2021, fotografitë e armës së konfiskuar të dt.04.01.2021 dhe nuk ka gjetur arsyeje për hedhje të aktakuzës meqë nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike siç është përcaktuar në dispozitën e nenit 248 par.1 pika 1.4 të KPPRK-së.

Në bazë të pranimin të plotë të fajësisë të të pandehurit Xh. Q. , si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës të cituara më lartë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar me seancën për caktim të dënimit.

Prokurorja e shtetit, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin i ka propozuar gjykatës, që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, gjendja e dobët ekonomike, si dhe të vlerësoj të gjitha rrethanat që kanë të bëjnë me matjen e dënimit dhe të njëjtit ti shqiptojë dënim në seanca të këtyre rrethanave.

I pandehuri Xh. Q. i ka propozuar Gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merren parasysh pranimi i fajësisë, gjendja e dobët ekonomike, ashtu që ka propozuar që ti shqiptohet një dënim më i butë.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 par.3 lidhur me par.1 pika 3.5 3, 3.6 dhe 3.7 të KP-së, ku si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur, më parë i pa dënuar, gjendjen e dobët financiare, derisa rrethana rënduese nuk gjeti.

Në bazë të nenit 52 të KPRK-së, dënimi me kusht mund ti shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilin me ligj është i paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet dhe për kryerësin e veprës penale për të cilin është paraparë dënimi deri në dhjetë vjet burgim, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit. Në rastin konkret i pandehuri ka kryer veprën penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të cilat parashihet dënim me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) € ose me burgim deri në pesë (5) vjet.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.1 të KP-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e saj, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos

kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KP-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin u marr konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor u marr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u marr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit.NR.05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.11/21

Bashkëpunëtore profesionale
Elzana Kastrati

Kryetarja e trupit gjykues
Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:008329
Datë: 04.02.2021
Numri i dokumentit: 01475835